

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

# NACIONAL

Drejtore:  
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

## Nis projekti "Amerika për Kosovën"

Nga Arbër Hadri

Në kuadër të veprimtarisë themelore të Muzeut të Kosovës e Zyrës për Çështje Jorezidente-ZKM, dhe me ndihmën e pakursyer ....

faqe 23



## Përurohet restaurimi i Tyrbes së Dervishit të Luzhës

Dervishi i Luzhës gëzoi një pozitë të lartë tek zoti. Si flijimtar i mekateve dhe vuajtjeve të përditshme të njerëzve, ai adhuroi qartë dhe fort cdo besimtar të ndjeshëm ndaj thirrjes së zotit.

faqe 22



## E VERTETA SI INTERPRETIM

Nga Skënder BUCPAPAJ

Hermeneutika lindi si nevojë e studimit të parimeve të përgjithshme të interpretimit të Biblës dhe kishte si qëllim kryesor zbulimin e të vërtetave dhe të vlerave të Biblës.....

faqe 2-3

## METAMORFOZA E GJEOPOLITIKËS

Nga Sadri Ramabaja

Në takimin e G-20 u venerua një unifikim politikash mbinacionale për kundërvënje ndaj efekteve shumëplanëshe që po prodhon kriza financiare,

faqe 6-7

## MBI DEBATET TELEVIZIVE

Nga Nazmi Lukaj -Prishtinë

Nëse e bëjmë këtë me vëmendje, lehtë do ta kemi të gjithë të konstatojmë....

faqe 8

## PËR ÇFARË KA NEVOJË KOSOVA

Nga Dr. Muhamet Sadiku

Çështja energjetike mbetet si njëra ndër aspektet më të ndieshme të përballjes së Qeverisë.

faqe 4

## SHQIPERIA, ZGJEDHJE TE NDERSHME

Në përgjithësi vëzhguesit e vlerësuan pozitiv procesin e votimit në shumicën e qendrave.

faqe 5

## SHQIPËRIA PO UNIFIKOHET

Nga Nexhmedin Spahiu


Këto zgjedhje, më shumë se cilatdo zgjedhje të tjera, e unifikuan Shqipërinë.

faqe 5

Intervistë me yllin e këngës shqiptare Adelina Ismajli

# Adelina Ismajli: Në Kosovë ndihem e shantazuar

faqe 12-15



## Gjithçka rreth nobelistit Ivo Andriç



Nëna e tij për shkak se qenë mjaft të varfër e dërgon që ta rrisi gjyshja e tij nga nëna në lindje të Bosnjës në një vend të quajtur Visegrad afër lumit Drin.

faqe 20

## Në BRENDËSI

### Hebrenjtë dhe Shqiptarët

Studim nga Gjekë Marinaj

faqe 10-11

### Vepra e Martin Camaj

Studim nga Dr. Adem Hajdaraj

faqe 10-11

### Rrënjë të ngurta

Poezi nga Azem Shkreli

faqe 16

### Lektyrat

Kritikë nga Dr. Avzi Mustafaj

faqe 8

### Kohë Manash

Tregim nga Sulejman Mato

faqe 17

### Një tjetër vis

Poezi nga poeti Bullgar Bino Ivanov

faqe 9

### Letërsia në gazetën "Dielli"

Dossier nga Naum Prifti

faqe 13

### Portreti i një humanisti

Ese nga Mujë Buçpapaj

faqe 23

### Kompleksi i Edipit

Poezi nga Kostandin Pavlllov

faqe 9



Në foto Gjeke Marinaj

## HEBRENJTË DHE MUNGESA

Në të vërtete mbështetja më e madhe e hebrenjve ka gjasa se erdhi në periudhën më të rëndësishme të Shqipërisë. Shqipëria po luftonte të fitonte pavarësinë nga Perandoria Osmane në vitin 1912. Vendi ndeshi qëndresën e jashtëzakonshme të shteteve fqinje, kryesisht të serbisë. Shqipëria shpalli pavarësinë prej osmanëve, më 28 nëntor të vitit 1912, deri diku falë mbështetjes së hebrenjve të cilët kishin lidhje jo të drejtpërdrejta me disa nga përfaqësuesit më të lartë austriakë. Pas pak muajve prej frikës së një komploti të mundshëm ndërkombëtar, por dhe shfuqizimin e pavarësisë së Shqipërisë u botua në gazetën e përjavshme "The Jewish Criterion", parulla nacionaliste shqiptare, "Shqipëria për shqiptarët", e cila ishte një nga botimet e para të huaja (The Jewish Criterion, volumni 35, numër 22, dt. 01.03.1912, faqe 1).

Nga Gjekë Marinaj

Është pohuar si nga hebrenjtë ashtu dhe nga jo-hebrenjtë se të gjithë hebrenjtë që qëndruan përbrenda kufijve të Shqipërisë gjatë periudhës së Holokaustit kanë mbijetuar disi. Por holokausti në vetvete nuk është një fjalë goje. Ai është një realitet. Ai është padyshim një nga krimet më mizore të kryera ndonjëherë në historinë e mbarë njerëzimit, dhe ndodhi pa asnjë arsye racionale. Nga viti 1939 deri në vitin 1944 rreth 2,000 hebrenj i kaluan kufijtë për në Shqipëri. Ata ia dolën mbanë të largohen nga shtete si Gjermania, Austria, Polonia, Rusia, Serbia, Greqia dhe Kosova dhe u bashkuan me pothuajse 200 hebreo-shqiptarë të tjerë, të cilët ishin bërë me kohë banorë të këtij vendi. Ata morën me vete kujtimet e familjarëve dhe komunitetet hebraike duke përfshirë fëmijët dhe disa prej të dashurve të tyre të gjymtuar, të cilët ose vdisnin urie nëpër geto, ose nazistët i vrisnin apo i mbysnin mizorisht në dhomat e gazit. Ndër këto kushte, hebrenjtë pranuan rrezikun e madh duke i besuar jetën Shqipërisë, e cila deri në atë kohë ishte një nga vendet më të varfra, më të vogla dhe më primitive në Evropë. Ata nuk u zhgënjyen asnjëherë sipas disa të mbijetuarve. Ata mbijetuan sepse gjetën një vend, populli i të cilit nuk qe prekur nga epidemia e anti-semitizmit, e cila ka qenë shkaku kryesor i Holokaustit në mbarë Evropën. Kjo ese do të shkojë më tej duke argumentuar si më poshtë: Shqiptarët ishin të mirë informuar se pa dyshim hebrenjtë mbeteshin miq dhe përkrahës të mëdhenj të Shqipërisë. Ata gjetën njohjen dhe praktikën e tolerancës së pashembull fetare në Shqipëri, e cila luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e miqësisë së re midis Shqipërisë dhe Izraelit, gjë që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Të gjithë u treguan të aftë të vendosnin unitetin social në zemrat e shqiptarëve dhe kjo e nxiti qeverinë shqiptare të asaj kohe (si edhe qeveritë marioneta) të ndërmarrin hapa të sigurt, edhe pse rrezikonin duke mos iu bindur urdhrat gjerman për zbatimin e ligjeve kundër hebrenjve. Por më e rëndësishmja, ngaqë pa dyshim mbetej gjëja e duhur për të bërë, shqiptarët qenë gati të përballeshin me rrezikun për jetën, vetëm për t'i shpëtuar miqtë e tyre hebrenj. Ndër shekuj, historia ka vërtetuar se hebrenjtë kanë qenë përkrahës të shqiptarëve. Siç del edhe nga gojëdhënat, miqësia midis shqiptarëve dhe hebrenjve e kishte zanafillën shumë kohë para Holokaustit. Ajo nisi rreth 2000 vjet më parë, kur skllevërit hebrenj që po transportoheshin nga Palestina për në Itali, ngecën në brigjet e Detit Adriatik. Menjëherë pasi mbërritën në Shqipëri, dorëzuan statusin e skllavit dhe u bënë qytetarë të zellshëm shqiptarë. Ata ishin ndër të parët që vunë re



Në foto fëmijë cifut, dalë gjatë Lufës II Botërore në Durrës

Në foto: Në mes, Johanna dalë në Durrës më 1944

një nga tiparet më njerëzore të traditës së këtij vendi që e konsideronte shtëpinë e vet si shtëpinë e Zotit dhe të miqve. Romakët pasi u forcuan erdhën në Shqipëri, ose t'i merrnin me vete hebrenjtë ose t'i vrisnin. Por ndeshën rezistencën e vazhdueshme të shqiptarëve, të cilët u ndjenë të fyer rëndë sepse po cenoheshin miqtë e tyre. Më vonë, nga fundi i shekullit të katërt, sipas historianit Zef Gjergji, hebrenjtë krijuan komunitet e tyre, që jo vetëm ia dolën të ishin të pavarur, por edhe ndihmuan vendin të nxiste sistemin e organizuar ekonomik dhe të zbulonte para tyre "parimet e ekonomisë ndërkombëtare" (nga intervista me Z. Gjergjin). Pra ndonjë "nuk kemi dijeni për numrin e hebrenjve në rajon gjatë epokës së hershme, kemi prova bindëse të komunitetit hebraik. Në disa fshatra të jugut jetonin qytetarë hebrenj dhe disa prej tyre morën emra në hebraisht, p.sh: Palasa-Palestina dhe Orikumi-Jeriko" (Sarnier 8). Pas kësaj nisje të mbarë miqësia midis hebrenjve dhe shqiptarëve u forcua edhe më shumë.

Në të vërtete mbështetja më e madhe e hebrenjve ka gjasa se erdhi në periudhën më të rëndësishme të Shqipërisë. Shqipëria po luftonte të fitonte pavarësinë nga Perandoria Osmane në vitin 1912. Vendi ndeshi qëndresën e jashtëzakonshme të shteteve fqinje, kryesisht të Jugosllavisë që kërkonte hyrjen e saj territoriale në Detin Adriatik. Shqipëria shpalli pavarësinë e sigurt prej osmanëve, më 28 nëntor të vitit 1912, deri diku falë mbështetjes së hebrenjve të cilët kishin lidhje jo të drejtpërdrejta me disa nga përfaqësuesit më të lartë austriakë. Pas pak muajve prej frikës së një komploti të mundshëm ndërkombëtar, por dhe shfuqizimin e pavarësisë së Shqipërisë u botua në gazetën e përjavshme "The Jew-

ish Criterion", parulla nacionaliste shqiptare, "Shqipëria për shqiptarët", e cila ishte një nga botimet e para të huaja (The Jewish Criterion, volumni 35, numër 22, dt. 01.03.1912, faqe 1). Megjithatë këto mbeten fakte pothuajse të papërmendura, si nga hebrenjtë ashtu edhe nga media izraelite. Përkundrazi. Në vend që të lëvdoheshin për të mirën që po i bënin Shqipërisë, hebrenjtë e asaj kohe benë siç benë më vonë disa nga të mbijetuarit e Holokaustit dhe fëmijëve të tyre si Joana J. Neuman dhe Ana Kohen të cilat shprehën vetëm fjalë dashurie dhe mirënjohje për Shqipërinë dhe shqiptarët:

"Unë e desha vërtet shkollën dhe ndihesha shumë mirë që isha si gjithë fëmijët e tjerë, isha më së fundi nxënëse shkollë... Kur vinte dimri dhe nisin shirat e rrëmbyer, të shkoje në shkollë vështirësohej edhe më shumë, por mua nuk më shkonte asnjëherë ndër mend të mungoja nga shkolla, qoftë edhe një ditë të vetme dhe për këtë isha vërtetë e lumtur. Kur mësuesja ndonjëherë duhej të dilte nga ora e mësimit, më kërkonte të merrja përsipër t'u shpjegoja mësimin fëmijëve." (Neuman 43).

Gjithashtu Kohen thotë:

"Në zemër të Evropës ndodhet një vend i vogël i quajtur Shqipëri, ku përfatin e mirë kam lindur, ku mikpritja për të huajt ishte pjesë e traditës. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët, jo vetëm shpëtuan hebrenjtë që jetonin mes tyre, por edhe rrezikuan t'i marrin në shtëpi, të ndajnë me ta bukën dhe jetën e tyre. Shqipëria pati pjesën e saj të Oskar Shindlers-ëve dhe të shumë të tjerëve që në të vërtetë nuk kemi pasur rastin të falënderonim çdonjërin prej tyre" (Dr. Ana Kohen).

Por me sa duket edhe shqiptarët qenë mirënjohës për ardhjen e hebrenjve në jetën e tyre. Njëri prej tyre ishte studiuesi shqiptar Vladimir Qirjaqi, i cili i përgëzoi hebrenjtë e qytetit të Gjirokastrës sepse jo vetëm "ndryshuan në një farë mënyre jetën

ish Criterion", parulla nacionaliste shqiptare, "Shqipëria për shqiptarët", e cila ishte një nga botimet e para të huaja (The Jewish Criterion, volumni

sociale të qytetit, e cila deri diku ishte e panjohur për ta më parë, por në të njëjtën kohë përcollën botëkuptimin perëndimor, duke sjellë një formë të re në menaxhimin e biznesit" (nga gazeta Shekulli). Përkrahja dhe vlerësimi i ndërsjellët nxiti disa prej hebrenjve si Pepe Biro Kantos, David Kohen dhe Jozef Bivas që të rekrutoheshin në çetat partizane duke rrezikuar edhe jetën për çlirimin e Shqipërisë. Ku siç pohon J. Altarak, edhe fëmijët e mirëpritën sakrificën e tyre pasi ia dolën të mësonin së paku të flasin gjuhën e njëri-tjetrit dhe të luajnë së bashku kudo nëpër rrugë. Familja e tij erdhi në Shqipëri kur ai ishte veçse 10 vjeç që t'i shpëtonte vrasjeve masive të hebrenjve që shpërthyen në ato kohëra në vendlindjen e tij, në Serbi. Ndërsa ai sjell ndër mend: "Ne, fëmijët kalonim kohë të mrekullueshme duke luajtur nëpër fusha, pranë përroit dhe në kopshtet me fruta. Shkonim të vizitonim edhe miqtë në familjet hebreje aty rreth e qark, në tokat tona dhe të tjera që ndodheshin aty pranë" (Nga intervista me J. Altarak).

Kjo u bë e mundur sepse të gjithë besimtarët; judaistët, myslimanët, katolikët dhe ortodoksët grekë shfrytëzuan larminë fetare si mjet për të kapërcyer vështirësitë. Ata e njohën Perëndinë si krijuesin e çdo kombi. Përmes kësaj njohjeje mundën të komunikojnë dhe gëzojnë tolerancën e hapur fetare që luajti një rol të jashtëzakonshëm në krijimin e marrëdhënies së re midis komuniteteve:

"Një ditë përjetova një çast tepër prekës. Isha duke luajtur në një fushë të madhe, jo shumë larg shtëpisë dhe u bëra kureshtar kur pashë se aty rriteshin kallinj gruri të mëdhenj e të plotë. Këputa njërin prej tyre dhe ndërsa vështroja me kujdes kallirin dhe prekja kokrrat e mëdha të grurit, m'u afrua një bujk plak që punonte në arë dhe më tha: "Këtë vit, kemi vit të mbarë. Kemi mysafir, ndaj Zoti na dha të korra të begata" (Nga intervista me J. Altarak).

Fatmirësisht Kisha Katolike shqiptare e gjeti veten jashtë ideve tradicionale të Kishës Katolike evropiane dhe nuk u përfshi në fushatën e organizuar për të ndikuar fuqishëm në nxitjen e besimtarëve të saj për urrejtje ndaj hebrenjve. Por ngaqë si institucion që ishte nuk hodhi ndonjë hap serioz në ndihmë të hebrenjve, disa katolikë iu bashkëngjitën haptazi thirrjeve të udhëheqësve shpirtërorë myslimanë që ndikuan në nxitjen e barazisë sociale pa dallim feje midis njerëzve. Përkrahësit myslimanë përbënin shumicën e grupit fetar në Shqipëri mes anëtarëve të dy besimeve të tjera. Ata ishin të vetëdijshëm për veprat e mira të traditës së hebrenjve dhe faktin se asnjë hebre nuk ishte dënuar për vepra kriminale në Shqipëri. Ndaj e pranuan

# E ANTI - SEMITIZMIT NË SHQIPËRI

an rrezikun e madh, ku edhe pse u pushtuan nga nazistët u bashkuan dhe bënë gjithçka mundën për t'i shpëtuar hebrenjtë. Kjo nuk mbeti pa u vënë re nga të mbijetuarit: "Populli shqiptar me gjithçka kishte i ndihmoi gjatë gjithë kohës hebrenjtë, duke nisur nga njerëzit më të thjeshtë si bujqit e varfër prej fshatrave të largëta e deri tek shtresat më të larta të shoqërisë shqiptare siç ishin familjet e pasura Toptani e Frashëri që ndanë me ta bukën dhe jetën familjare" (J. Altarac). Pjesa më e madhe e hebrenjve erdhën nga Gjermania. Idetë e tyre shkencore ishin hedhur poshtë vetëm sepse ato ishin ide hebrenjsh. Por në Shqipëri jo vetëm idetë por edhe shoqëria e tyre ishte më se e mirëpritur. Sikurse kujton Neuman-i, hebrenjtë nuk ngurronin të shkonin në xhami, sa herë që i ftonin myslimanët: "Ne merrnim ftesa nga fqinjët myslimanë për të shkuar bashkë me ta në Xhami. Ata ishin shumë mikpritës. Në përgjithësi shqiptarët janë të tillë" (Neuman 38). Shumica e hebrenjve nuk kishin paragjykime dhe ishin mirënjohës për ftesën miqësore nga ana e shqiptarëve, aq sa disa prej tyre vendosën edhe emra myslimanë për t'iu fshehur nazistëve. Kohen sqaron në lidhje me këtë çështje:

"Prindërit e mi, Nina dhe David Kohen vinin nga Janina e Greqisë. Kur nazistët pushtuan Shqipërinë, jetonin në Vlorë. Ata u larguan nga malet dhe u fshehën në një fshat të vogël mysliman të quajtur Trevlazër. Babai im nga David mori emrin Daut, nëna ime nga Nina u quajt Bule dhe vëllai im Elio u quajt Ali. Në fshat, të gjithë e dinin se ishin hebrenj, por askush nuk i tradhtoi" (Kohen).

Në përgjithësi, as ortodoksia greke, si katolicizmi nuk ishte veçanërisht vepruese në përbushjen e nevojave të hebrenjve, por as ajo asnjëherë nuk ndërmori fushata kundër tyre.

Prapëseprapë, qeveria shqiptare u duk të ishte pak më tepër vepruese në mbështetje të hebrenjve. Ata njohën ndjenjat e popullit të tyre ndaj miqve dhe rrezikuan të mos i binden urdhrët gjerman për të zbatuar ligjet kundër hebrenjve. Qeveria shqiptare kishte për qëllim të ishte mbështetëse, edhe pse e mbijetuar Rina Shosberger është e mendimit se "qeveria nuk e dinte se ku ndodheshin hebrenjtë" (Shosberger), por ajo shpreh të gjithë mirënjohjen për njerëzit shqiptar të cilët "i ndihmuan aq shumë dhe asnjëherë nuk i tradhtuan përpara nazistëve" (Shosberger). Në fakt, qeveria shqiptare ka qenë e vetmja qeveri në rajon që shpresonte në shtimin e komunitetit hebre në vend. Ajo i ndihmoi duke u dhënë emra dhe dokumente të rreme dhe i vendosi nëpër lagjet e vendit për ta bërë komunitetin të mos binte në sy përpara nazistëve deri sa edhe ata të ngatëroheshin aq sa "herë pas here ndërronim identitetin me dokumente false, sa që as unë nuk po e kuptoja se kush isha në të vërtetë" (Altarac). Shqipëria i konsideronte hebrenjtë të rëndësishëm. Asaj i nevojitej përvoja e bizneseve dhe ideve të reja, arsimimi dhe profesionalizmi në arte e shkencë të cilën nuk ngurronte ta shprehte. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas Harvey Sarner-it, kur Mbreti Zog ndodhej në

mërgim në Britaninë e Madhe:

"Propozoi një plan pranë grupit drejtues Hebreo-Britanik për sistemimin e 50 mijë familjeve hebrenjsh në Shqipëri. Ai e përshkruante Shqipërinë si një vend të pasur, por me njerëz të varfër dhe tha se në një vend të tillë me popullsi një milion mund të ishte e lehtë të pranoheshin rreth pesë milion njerëz. Ai propozoi t'u jepte një ngastër toke bujqësore nga pasuria shtetërore secilës prej këtyre 50 mijë familjeve. Grupi i Deputetëve Britanik, i cili përfaqësonte hebreo-britanikët, e mori propozimin seriozisht dhe e përcolli atë në Zyrën Britanike për Çështjet e Jashtme. Kjo zyrë nuk e mori propozimin me seriozitet dhe dyshoi se pas Luftës së Dytë Botërore, Mbreti Zog nuk do të mund ta rivendoste monarkinë e tij në Shqipëri. Zogu vdiq në mërgim dhe propozimi nuk u zbatua" (Sarner 13).

Gjermanët ishin në dijeni për propozimin e Zogut dhe kërkuan që qeveria shqiptare t'u jepte listën e hollësishme të emrave dhe adresave të hebrenjve. Por kjo nuk ndodhi asnjëherë. Kjo është arsyeja përse Joana Juta Neuman shpreh keqardhje se "jo



shumë prej hebrenjve kishin dijeni për Shqipërinë dhe shqiptarët. Kjo nuk ishte gjë e mirë, sepse nëse do ta kishin ditur, shumë më tepër hebrenj do të kishin shpëtuar." (Nga intervista me Neuman). Madje edhe kur qeveria e përkohshme italiane u zëvendësua nga qeveria gjermane, në shtator të vitit 1943, kryeministri i parë shqiptar, Mehdi Frashëri, kishte pak të ardhura dhe mbi të gjitha zotëronte pak forcë politike për të plotësuar nevojat imediate shëndetësore, financiare dhe politike të hebrenjve. Duke njohur rrethanat, hebrenjtë e ardhur i mirëpritën sigurimin e ndihmave të pakta financiare. Për më tepër, qeveria nuk i ndaloi asnjëherë donatorët shqiptarë dhe të afërmit e hebrenjve në Amerikë, të cilët ishin të gatshëm t'i ndihmonin financiarisht. Në këto kushte nuk ka prova që qeveria t'i nxiste hebrenjtë të ndërmerrnin vendime të menjëhershme të rëndësishme kundër vullnetit të tyre, siç ishte p.sh largimi nga vendi.

Megjithatë ashtu siç do të binin dakord shumica e njerëzve, ajo që qeveria bëri më mirë ishte fakti se kurrë nuk ndërmori ndonjë masë ndëshkimore ndaj shqiptarëve për shkak se ndihmuan hebrenjtë. Edhe pse nuk kemi prova reale se ndonjë nga shqiptarët humbi jetën ndërsa kërkonte të

mbronte hebrenjtë, një pjesë e mirë e tyre e rrezikuan atë, sa herë kërkonin t'i mbronin. Gjatë programit të studimit tim për këtë ese, disa nga burimet e mia përmendin të njëjtit emra dhe rrëfenin pothuajse të njëjtat ngjarje heroike që e kisha lexuar në librin akademik, të shkruar po për këtë çështje me titull "Shpëtimi në Shqipëri" me autor Harvey Sarner-in. Ndaj është më se e drejtë të përdorim këtu shembujt e mëposhtëm që janë pjesë e tekstit të tij, për të ilustruar disa veprime me rrezikshmëri të ndërmarra nga shqiptarët në mbështetje të miqve të tyre:

1. "Hebrenjtë e ardhur që u liruan nga burgjet italiane u vendosën me banim në Kavajë në vitin 1942. Këto familje nuk kishin letërnjoftime dhe kjo ishte shqetësuese. Mihal Lekatari ishte një djalë 17 vjeçar ortodoks dhe e kuptoi rrezikun me të cilin po përballeshin familjet hebreje. Në të gdhirë, Mihali u bë gati dhe shkoi në zyrat e selisë qendrore. Ai nuk priste askënd të vinte kaq herët, por atje gjeti sekretaren që ishte duke punuar. Pasi mori rreth 50 letërnjoftime bosh, kërcënoi me vdekje sekretaren duke i thënë: "nëse më

raporton të vrava ty dhe familjen tënde."

2. Familja e Refik Veselit strehoi familjet hebreje për një vit rresht. Rreth 50 metra nga shtëpia e Veselit ndodhej një shpellë, ku hebrenjtë shkonin sa herë që vinin gjermanët për kontroll. Ata asnjëherë nuk i bënë të ndjeheshin të jo-mirëseardhur dhe nuk pranuan prej tyre asnjë kompensim financiar.

3. Miku hebre i Beqir Qoqes, Avraham Eliasaf (që e thërrisnin me emrin mysliman Gani) banonte në Tiranë, në rrobaqepësinë e Beqirit. Kur gjermanët ndërmorën operacionin "fshesa" që ishte spastrimi nga hebrenjtë, vendosën se ishte më e sigurt ta shpërngulnin Avrahamin duke e kaluar si mysliman në një fshat të largët. Për shkak të kësaj ndihme, Avrahami i dha Beqirit disa monedha floriri. Pas çlirimit, Beqiri ia riktheu monedhat mikut të tij dhe nuk e pranoi kompensimin, si dhe refuzoi propozimin për t'i marrë monedhat e floririt.

4. Përmes shtëpisë së Nadire Bixhiut kaluan mbi 80 hebrenj ikanak, e cila u gjeti një vend të sigurt, edhe pse nuk i njihte shumë prej tyre. Ferri Hoxha u tregoi rrugën për në fshatin Zall Herr disa hebrenjve, ku ndodhej një shtëpi shumë e madhe. Në këtë shtëpi u strehuan shumë njerëz dhe u ushqyen 80 vetë, si edhe disa ushtarë ital-

ianë që dezertuan nga ushtria pas kapitullimit të Italisë" (Sarneri 46 – 48).

Si përfundim, ndërsa po intervistojta Felisita Jakoelin, vajzën e njërit prej të mbijetuarve

më të njohur të Holokaustit, Jozef Jakoelin, më lindi pyetja, a kishte pasur në Shqipëri gjurmë të anti-semitizmit. Një pyetje e tillë m'u duk se e acaroi dhe më tha: "dëgjo, anti-semitizmi nuk ka ekzistuar ndonjëherë në Shqipëri" dhe ngriti paksa tonin e zërit. Ambasadori izraelit Mark Sofer, shkruan në një prej artikujve në gazetën "Southeast European Times" të muajit mars, të vitit 2006, se "Jo vetëm në Izrael, por edhe në mbarë botën, hebrenjtë e admirojnë Shqipërinë. Jo vetëm se Shqipëria shpëtoi hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe sepse ai shtet është i njohur për respektin e tyre ndaj nesh. Mund të them se Shqipëria nuk ka pasur asnjëherë anti-semitizëm" (Nga Southeast European Times, numër 1). Gjithashtu një nga diplomatët e parë izraelit në postin e ambasadorit amerikan në Shqipëri, Herman Berstein (nga viti 1930 – 1933), shkruan për gazetën e përditshme "The Jewish Daily Bulletin" të datës 17 prill, 1934: "Në Shqipëri nuk ka asnjë gjurmë diskriminimi ndaj hebrenjve, se Shqipëria vazhdon të jetë një nga shtetet më të veçanta të Evropës, ku edhe sot e kësaj dite nuk ekzistojnë paragjykime dhe urrejtje fetare, edhe pse vetë shqiptarët u përkasin të besimeve..." (The Jewish Daily Bulletin, numër 1). Ajo që dua të përsëris është se, në Shqipëri nuk kishte anti-semitizëm, ç'ka duhet të jetë e vërtetë, pasi këtë e thonë të gjithë: si përfaqësuesi që jetonte para 74 vjetëve në Shqipëri, si diplomati i sotëm në Izrael që punonte para dy viteve (për të mbajtur lidhje të mira me Shqipërinë), ashtu edhe të mbijetuarit e Holokaustit bashkë me fëmijët e tyre. Shpresoj të kem sjellë provat e mundshme dhe arsyet reale për të vërtetuar tezat e mia se, hebrenjtë ia dolën të mbijetonin në Shqipëri, vetëm sepse gjetën një vend ku njerëzit nuk u prekën nga sëmundja e rrezikshme e anti-semitizmit, e cila ka qenë zanafilla kryesore e holokaustit në gjithë Evropën. Për mua, e gjitha kjo ka kuptim, pasi për shekuj me radhë, shqiptarët u masakruan nga shpata e turkut, u vranë nga italianët dhe u pushkatuan nga nazistët gjermanë. Si rezultat ata luftuan me gjithçka kishin, ku shumë prej tyre rrezikuan dhe humbën jetën, vetëm që të çliroheshin nga armiqtë mizorë. Pas kësaj erdhën hebrenjtë me kalvarin e gjatë të vuajtjeve dhe diskriminimit, i cili arriti pikën kulmore të paparë ndonjëherë në mbarë historinë e njerëzimit, dhe për t'i mbijetuar mizorive të nazistëve gjermanë kërkuan një vend të përkohshëm për t'u strehuar në Shqipëri. Nisur nga përvoja e jashtëzakonshme të së shkuarës dhe të së tashmes me hebrenjtë, shqiptarë vendosën se ia vlente të merrje përsipër të njëjtat rreziqe për të shpëtuar hebrenjtë që patën marrë kur luftuan kundër armiqve për të ruajtur nderin, identitetin dhe lirinë e tyre. Sigurisht që ata kanë bërë zgjedhjen e duhur.

Përktheu nga anglishtja: Irena Papingji